

1- Sodium Nitrite & Sodium Nitrate (E250,E251)

Ndodhet në disa lloje proshutash, sallamrash, peshk të tymosur, salcice frankfurter:




Sipas studimeve dhe testimeve të ndryshme mendohet se Sodium Nitrite dhe Nitrate shkakton tipe të ndryshme të kancerit.

Më të rrezikuar janë gratë shtatëzëna dhe fëmijët.



2- Ngjyrimi artificial (Portokalli B; Jeshile C; E kuqe D; Blu 2; E verdhë 5; E verdhë 6)

Ndodhet në suxhuk, karamеле, xhelatinë, ëmbëlsira, pije të ndryshme, mallra të pjekur, ushqime për kafshët etj



Këto ngjyime të përdorura gjërësisht shkaktojnë mbindjeshmërinë kryesisht në persona që janë të ndjeshëm nga aspirinat.



Sipas testimeve në kafshë, ngjyrimi artificial shkakton edhe tumor në veshka, masa kancerogjene dhe kancer në tru.

3-Mërkuri (Hg)

Mërkuri është një metal që ndodhet natyrshëm në mjedis. Ai mund të jetë i ngurtë (argjend i bardhë), i lëngshëm dhe nëse ndizet ai kthehet në gaz pa ngjyrë.



Ne jemi të ekspozuar ndaj mërkurit duke ngrënë produkte deti por edhe duke marrë frymë në një ajër të ndotur me mërkur.



Ekspozimi ndaj niveleve të larta të mërkurit shkakton helmim, si pasojë:

- **Dëmtime të përhershme të trurit: dridhje, haluçinacione, psikozë, ndryshimet në vizion dhe dëgjim, probleme të kujtesës, humbje të oreksit, të peshës dhe nervozizëm.**
- **Dëmtime të përhershme të veshkave**
- **Në gratë shtatëzëna dëmtim të fetusit deri në abort**
- **edhe vdekje.**